



MISIONI SHQIPTAR

Shën Nënë Tereza

Saint Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Jeruzalem

25 Mars 2018



Kur iu afruan Jerusalemit, te Betfaga e te Betania, afër Malit të Ullinjve, Jezusi i dërgoi dy prej nxënësve të vet dhe u tha: “Shkoni në fshatin që është para jush. Posa të hyni, do ta gjeni një gomar të lidhur, të cilit askush ende nuk i hypi në shpinë. Zgjidheni e ma bini. Po që se ndokush ju pyet: ‘Çka po bëni ashtu?’ – përgjigjuni: ‘Po i duhet Zotërisë’, dhe ai menjëherë do ta kthejë prapë këtu.” Ata shkuan, e gjetën gomarin e lidhur përjashta te dera në rrugë dhe e zgjidhën. Disa që ndodhën aty i pyetën: “Çka po bëni? Pse po e zgjidhni gomarin?” Nxënësit përgjigjën si u kishte thënë Jezusi. Nuk i penguan. Ata ia çuan gomarin Jezusit, qitën mbi të petkat e veta dhe Jezusi hypi në të. Shumë njerëz i shtrinë petkat e veta udhës e disa tjerë gemat që këputnin nëpër ara. Si ata që shkonin para Jezusit, si ata që i shkonin pas, klithnin: “Hosana! Qoftë bekuar ai që vjen në Emër të Zotit! Qoftë bekuar Mbretëria që po vjen e atit tonë Davidit! Hosana në qiejtë më të lartat!” *Mk 11, 1-10*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 PM te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

27 Mars	Shen Rupert
29 Mars	E Enjtja e Madhe
30 Mars	E Premtja e Madhe
31 Mars	Vigjilia e Madhe e Pashkeve
01 Prill	E diela e Ringjalljes

Haku Kishes 2018... Ilir Frrokaj, Vitor Mernaçaj

Aleks	Dragu
Arben	Therqaj
Arben	Pepa
Edi	Linadi
Edmond	Gjeta
Eduard	Avullija
Eduard	Gega
Fred	Kalaj
Gac	Gjoka
Ilir	Shyti
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Lec	Gashaj
Luigj	Gjokaj
Luigj	Cukaj
Luk	Gjolaj
Luvigj	Lallinaj
Mario	Martini
Mikel	Paplekaj
Petrit	Ujka
Pjerin	Brucaj
Pjeter	Dreshaj
Prek	Gjonaj
Sokol	Ujka
Suela	Mangelli
Valete	Gjokaj
Viktor	Gjoka


Per Fondin e ndertimit te Kishes ka dhene ...

Pjeter&Bep Dreshaj	12000
Ton Vocaj	12000
Sokol Sterbyci	11000
Aleks Coku	7000
Anton Malaj	6000
Luigj Narkaj	6000
Prek Gjonaj	6000
Elis Bzhetaj	5000
Kreshnik Kapaj	5000
Lec Gashaj	5000
Luk Gjollaj	5000
Miri Sufaj	5000
Paulin Marku	5000
Tonin Kastrati	5000
Mario Martini	5000
Anton Brunga	4000
Luvigj Lallinaj	4000
Mirash Lallinaj	4000
Arben Toma	5000
Dritan Lumaj	3000
Nik Biqi	3000
Prek Spaqi	3000
Tom Prekulaj	3000
Altin Miri	2500
Albert Berisha	2000
Aleks Dragu	2000
Artan Vuksani me vellezer	2000
Besnik Arinaj	2000
Edmond Ramaj	2000
Ergys Ndreu	2000
Fred Kalaj	2000
Gjelosh Vushaj	2000
Jetnor Smakaj	2000
Luigj Gojani	2000
Martin Vuktilaj	2000
Ndok Gjokaj	2000
Petrit Ujka	2000
Pjerin Kalaj	2000
Prek Lekaj	2000
Shpend Pllumbaj	2000
Sokol/Petrit Ujka	2000
Vasel Nush Dreshaj	2000
Gjovalin Melaj	1500
Lek Selmani	1500

Ndue Selmani	1500
Sokol Kaçaj	1500
Aleksander Stolaj	1000
Angjelin Kaçaj	1000
Angjelin Rrashkadolli	1000
Anton Shelinaj	1000
Arben Therqaj	1000
Dede Ukaj	1000
Don Ambroz Demaj	1000
Edi Linadi	1000
Erald Islami	1000
Fabjan Pllumaj	1000
Gentjan Lelcaj	1000
Gezim Lanazi	1000
Gjergj Gjinaj	1000
Gjon (Gjoro) Kaçaj	1000
Gjon Dreshaj	1000
Ladi Lumaj	1000
Lec Ndoj	1000
Lek Ramaj	1000
Leke Koja	1000
Leonard Pepaj	1000
Mark Ndoci	1000
Martin Pjetri	1000
Mhill Bregu	1000
Mhill Ftoni	1000
Ndoc Bregu	1000
Ndue Cacaj	1000
Ndue Kabashi	1000
Nikolin Vukelaj	1000
Nush Dokaj	1000
Petrit Stolaj	1000
Pjerin Vukcaj	1000
Pjeter Preka	1000
Prek Kaçaj	1000
Prek Spaqi	1000
Prel Pushaj	1000
Qamil Llashtica	1000
Shçiprim Lumi	1000
Sokol Gashaj	1000
Sokol Noshi	1000
Viktor Gjokaj (Dokaj)	1000
Vilson Prekaj	1000
Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!	



E Diela e Larit: Jezusi ngjitet në Jeruzalem



Java e Shenjtë e Pashkëve dhe mesazhi i saj

Me të Dielën e Larit, besimtarët katolikë fillojnë Javën e Madhe të Pashkëve. Po çfarë kuptim ka kjo 'Javë' e cila është domethënia e ditëve të saj, që shënojnë kulmin e vitit liturgjik të Kishës ? Domethënia është se Kisha Shenjte Amë kremton misteret e Dhëndrit të vet Shpërblyes. Jezu Krishti zbriti mbi tokë dhe u Mishërua për dashurinë e për shëlbimin tonë. Na shpëtoi me gjithë jetën e Tij: me mrekullitë, me predikimet por në mënyrë të posaçme, me mundimet, me vdekjen dhe ngjalljen e Tij. Këtë kremtojmë gjatë Javës së Madhe të Pashkëve që posa kemi filluar.

E dimë se kremtimi Eukaristik i Meshës Shenjte është një riparaqitje e mistereve të Krishtit që mundohet, vdes e ngjallet; e flijimi i Kryqit është ora e Jezusit. Çdo i krishterë, çdo katolik e rijeton këtë flijim, kremton me Kishën, në Kishë, bën përpjekje për t'i lexuar e kundruar misteret e fesë së krishterë përmes riteve liturgjike, para se të niset drejt Kishës, për t'i ndjekur pastaj më mirë, për të marrë pjesë më me përshtirë. Pjesëmarrja nuk është thjeshtë veprimtari e jashtme rituale: në radhë të parë është bashkim shpirtëror me Krishtin dhe me

Mbrëmje për Pashkë...

Te dielen 1 prill ne oren 7 PM. Per çdo informacion thirr ne numrin 647.671.462

Kishën. Natyrisht çdo besimtar kërkon më parë të rrëfihet, ta marrë në zemër Jezusin Eukaristi, të vihet për udhë të dashurisë së bashku me Kishën, së bashku me të Lumen Mari, gjithmonë Virgjër, që ishte pranë Krishtit kudo, posaçërisht mbi Kalvar e pranë Kryqit. Vihet për udhë edhe me Apostujt.

Kush nuk e kupton Javën e Madhe të Pashkëve, nuk e kupton krishterimin; kush nuk merr pjesë në ritet kishtare që na përkujtojnë e kremtojnë misteret e fesë, është tepër i cektë në jetën e krishterë. E kjo, sepse Pashkët i japin kuptim çdo Meshe, çdo Eukaristie e kremtimi tjetër, posaçërisht kremtimit të Meshës çdo të diele që ne kremtojmë në ditën e parë të javës. E ditën e parë të javës, jo më të shtunën, por të dielën - ne e kremtojmë si Ditën e Zotit, si Ditën e Ngjalljes së Krishtit. S'kemi jetë pa të dielën - kanë thënë martirët e Abitenes, në Afrikën veriore. Ja, pra, kuptimi i Javës, që është zemra e vitit liturgjik të Kishës.

Në atmosferën e shenjtë të kësaj Jave të Pashkëve, është e trishtueshme të mendosh se për disa njerëz Pashkë do të thotë vezë të kuqe, shëtitje në det, vizita në shtëpitë e miqve, udhëtime pa fund, shëtitje në mal, ndeshje sportive, ngujim para televizorit.... Të gjitha këto gjëra janë të mira, nuk janë të këqija. Por sigurisht nuk janë zemra e Pashkëve. Zemra e thelbi i Pashkëve është pjesëmarrja në kremtimet e mistereve të Krishtit, të pranishme në liturgjinë Kishtare. Secili nga ne duhet ta programojë gjithçka tjetër rreth kremtimit të këtyre mistereve, përfshirë këtu edhe pushimin.

Kujtojmë edhe huret e posaçme që fitohen duke marrë pjesë me gjithë shpirt në kremtimet e Javës së Madhe. Si gosti shpirtërore rreth sofrës së Zotit, Jezusi na ushqen me fjalën e tij, me sakramentet e tij, me Korpin e Gjakun e tij, na ushqen edhe me shoqërinë e mbarë bashkësisë së krishterë, sepse Zoti nuk na shpëtoi si

një njeri i vetëm, por edhe si bashkësi. Kemi nevojë për të tjerët: për të qenë bashkë.

Po t'i vështronim nga afër ritet e shenjta dhe simbolet e liturgjisë së kësaj jave të madhe të Pashkëve, askush nuk mund të thotë se gjithë këto pamje nuk flasin vetë për dashurinë e pakufishme dhe shëlbimprurëse të Jezu Krishtit Zot, figurën dhe veprën e të cilit, pikërisht përmes riteve e simboleve liturgjike e fetare të kësaj Jave të Shenjtë, që Kisha na propozon në një mënyrë krejt të veçantë, duke na ftuar të marrim pjesë në misteret e shëlbimit shpirtëror.

Prandaj ngjarjet e Javës së Shenjtë të Pashkëve i nxisin të krishterët, sipas shembullit të Jezu Krishtit, të bëhen apostuj të pages e të dashurisë në një botë shpesh të dhunshme e të paaftë për të falur e për t'u pajtuar me Zotin dhe të afërmin. Kështu, Kisha na fton të përgatitemi për Pashkë me një rrëfim të mirë, detyrë e rëndësishme kjo, që na jep mundësinë ta rifillojmë përsëri jetën tonë në Zotin, të kemi realisht një fillësë të re në gëzimin e të Pashkëve e në bashkimin e faljes, dhuruar nga Krishti i Ngjallur.

ARRA
LAW FIRM

Anisa Arra, BSc, JD
Barrister & Solicitor

P. 905.491.6977
F. 905.491.6974
anisa@arralawfirm.com

www.arralawfirm.com

466 Morden Road, Suite 202
Oakville, ON L6K 3W4

BRUNGA LAW
BARRISTERS & SOLICITORS

Anton Brunga | Lawyer

- Real Estate
- Immigration Law
- Testaments
- Business & Corporate Law
- Visas & Sponsorships
- Prokura & Family Law

416-234-5111
www.brungalaw.com